



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:188454

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05429053

P.nr. 2781/22

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues, Sabit Sadikaj, me bashkëpunëtorin profesional Asdren Selmani, në çështjen penale kundër të pandehurit A.J për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer në vazhdimësi veprën penale “Vjedhje ” nga neni 315 par 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.2395/21 e datës: 18.10.2022, duke vendosur sipas kërkesës për kundërshtimin e provave dhe hedhje të aktakuzës të paraqitur me datë: 13.12.2023, nga mbrojtësi, sipas autorizimit i të pandehurit, Av. Feim Maliqi, jashtë seancës me datë: 06.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET kërkesa për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtim të provave, e paraqitur me datë: 13.12.2023, nga mbrojtësi sipas autorizimit i të pandehurit A.J, Av. Feim Maliqi, kundër aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr.2395/21 e datës: 18.10.2022, si e pa bazuar.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.2395/21 e datës: 18.10.2022, ndaj të pandehurit A.J, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer në vazhdimësi veprën penale “Vjedhje ” nga neni 315 par 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata për këtë çështje ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestare me datë: 14.11.2023, në prezencë të Prokurores se Shtetit, Lulzim Aliu, mbrojtësi sipas detyrës zyrtare i të pandehurit, Av. Feim Maliqi, si dhe i pandehuri A.J, ne te cilën seance i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë ka deklaruar se ndihet i pafajshëm për veprën penale me të cilën ngarkohet, sipas aktakuzës së lartcekur, po ashtu i pandehuri është njoftuar nga gjykata për të drejtat e tij komfor nenit 240 par.7 të KPPRK-së.

Mbrojtësi i të pandehurit Av. Feim Maliqi, me parashtresën e datës: 13.12.2023, ka paraqitur kërkesën për kundërshtimin e provave dhe hedhjen e aktakuzës, për shkak se Prokuroria ne

Aktakuzën me PP.II.nr.2395/21 e datës: 18.10.2022, kundër të pandehurit A.J, pasi që pretendon se aktakuza është e pa argumentuar dhe e njëjta nuk është e bazuar në ligj e po ashtu është e pa argumentuar me prova, e po ashtu ka theksuar se nuk ka prova të mjaftueshme të cilat argumentoj se i mbrojturi i tij është fajtor, si dhe ka pretenduar se aktakuza është ngritur nga prokuroria edhe pse i mbrojturi i tij nuk është marrur në pyetje në prokurori, edhe pse vepra për të cilën dënohet është e dënueshme më shumë se 3 (tri) vite, andaj kërkon nga gjykata që aktakuza të dhe të pushoj procedurën penale ndaj të pandehurit A.J.

Gjyqtari i vetëm gjykues, me datë: 18.12.2023, ka kërkuar nga Prokuroria Themelore përgjigje në kërkesën për hedhjen të aktakuzës lidhur me lëndën me P.nr. 2781/, sipas aktakuzës PP.II.nr.4644/20 e datës: 14.10.2022, përgjigjen duhet ta ofroni brenda afatit ligjor apo prokurori i shtetit brenda kohës prej pesëmbëdhjeta(15) ditëve i ofrohet mundësia për të paraqitur përgjigje me shkrim ndaj kundërshtimit nga neni 245 të KPPRK-së.

Prokuroria Themelore ne Prishtine nuk ka paraqitur përgjigje në kërkesën për kundërshtim të provave dhe hedhje të aktakuzës PP.II.nr.4644/20 e datës: 14.10.2022.

Pas shikimit si dhe analizimit me kujdes të kërkesës për kundërshtim të provave dhe hedhje të aktakuzës të paraqitur nga mbrojtësi i të pandehurit Av. Nysret Islami, si dhe shkresave të lëndës, gjykata konstatoi se kërkesa për kundërshtimin e provave dhe hedhje të aktakuzës, është e pa bazuar.

Gjyqtari i vetëm gjykues gjeti se aktakuza si e tillë është përpiluar në pajtim me nenin 235 par. 1 të KPPRK-së, e njëjta nuk përmban të meta të atilla që pamundësojnë vazhdimin e procedurës penale dhe se përmban të gjitha elementet e nevojshme që të mund të procedohet në fazat tjera të procedurës penale, njëherit, mbështetet në prova thelbësisht të mbështetshme dhe të marra konform dispozitave ligjore dhe se nuk ka vend për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtim të provave ashtu siç pretendohet nga mbrojtësi i të pandehurit se provat që gjenden në shkresa të lëndës nuk provojnë që i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, po ashtu pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit se duhet të nxirret ekspertizë për të konstatuar dëmin e shkaktuar, si dhe për të konstatuar shumën e dëmit pasi që shuma sipas aktakuzës nuk është reale, gjykata të gjitha këto pretendime i hedhe poshtë pasi që, për të marr ekspertizë për vlerën e dëmit si dhe për të konstatuar se a ka prova të mjaftueshme se i akuzuari ka kryer veprën penale të cilën i vihet në barrë, duhet të shkohet në shqyrtim gjyqësor për të u vërtetuar nëse i njëjti është fajtor apo i pa fajshëm, sipas vlerësimit të gjykatës provat nuk janë marrë në mënyrë të kundërligjshme dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore, të njëjtat kanë bazë të artikuleshme që gjykata t'i çmojë si thelbësisht të mbështetshme, sepse dihet origjina e provave dhe si të tilla do të elaborohen më hollësisht në shqyrtimin gjyqësor, e me ç' rast do të vërtetohet edhe besueshmëria e tyre, e pastaj do të vendoset me vendim merititor.

Gjykata po ashtu ka vlerësuar edhe pretendimet mbrojtësit të pandehurit se nuk është provuar me anë të provave se ekziston dyshimi i bazuar, gjykata konstaton se për të u vërtetuar fajësia apo pa fajësia, duhet të shkohet në shqyrtim gjyqësor, pasi që në këtë fazë të procedurës nuk

është e lejuar për të vërtetuar fajësinë apo pafajësinë e palës së akuzuar, andaj vlerëson se në këtë fazë të procedurës penale të gjitha këto pretendime janë të pabazuara, sepse vërtetimi gjendjen faktike të provave nuk mund të shqyrtohet në këtë fazë të procedurës penale, për faktin se gjykata nuk është e autorizuar të bëjë vlerësimin e provave në këtë fazë të procedurës, pretendimet së bashku me provat që i janë bashkangjitur aktakuzës në rastin konkret, janë çështje që do të vlerësohen dhe vërtetohen në shqyrtimin gjyqësor të mëtejshëm pas administrimit të provave, ku edhe do të vërtetohet fajësia apo pafajësia e të pandehurit.

Prandaj, bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues vlerëson se çështja penale duhet të kalojë në shqyrtimin gjyqësor, në mënyrë që të bëhet administrimi i provave të cilat i janë bashkangjitur aktakuzës, si dhe pas analizimit dhe shqyrtimit të provave të vërtetohet në tërësi gjendja faktike.

Nga sa u tha më lart, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 243 par. 3 dhe nenit 244 par. 3 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE – DEPARTAMENTI I
PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2022:188454, 08.03.2024

Bashkëpunëtori profesional
Asdren Selmani

Gjyqtari i vetëm gjykues
Sabit Sadikaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimi të këtij Aktvendimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.